



21.09.2018



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ  
OSNOVNI SUD UROŠEVAC - BASIC COURT OF FERIZAJ

C.nr.840/17

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm-gjyqtari Alban Beqiri, në çështjen juridike të paditësit [REDACTED] nga Ferizaj Rr.'[REDACTED]' p.n., të cilin e përfaqëson av. [REDACTED] nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna e Ferizajt- Drejtoria për Arsim- Ferizaj, në çështjen për pagesën e pagave përcjellëse dhe jubilare, në prezencën e të autorizuarës së paditësit dhe të përfaqësuesit të paditurës, në shqyrtimin e mbajtur me dt.15.08.2018, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. **APROVOHET** në tërësi kërkesë padia e paditësit [REDACTED] si e bazuar.

II. **DETYROHET** e paditura që paditësit ti paguaj shumën e përgjithshme prej 3,132.66€ (tremijë e njëqind e tridhjetë e dy euro e gjashtëdhjetë e gjashtë cent) dhe atë shumën prej 1,566.33€ (njëmijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë euro e tridhjetë e tre cent), në emër të pagesës së tri pagave jubilare dhe shumën prej 1,566.33€ (njëmijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë euro e tridhjetë e tre cent), në emër të pagesës të tri pagave për përcjellje në pension, me kamatë ligjore prej 8% prej ditës të paraqitjes padisë dt.22.09.2017 deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 279€, të gjitha brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcenime të përmbarimit me dhunë.

## A r s y e t i m i

Paditësi përmes të autorizuarës së tij ka deklaruar se nga provat e administruara është vërtetuar baza juridike e kërkesë padisë si dhe lartësia e saj e precizuar, pasi që sipas kontratës kolektive e paditura ka pasur detyrim që paditësit me rastin e daljes në pension t'ia paguaj tri paga jubilare dhe tri paga në përcjellje në pension të cilën gjë nuk e ka bërë as pas kërkesës drejtuar në procedurë administrative, sa i përket pretendimit të paditurës se pagat jubilare janë parashkruar e ka kundërshtuar një gjë të tillë pasi që të njëjtat me kontratën kolektive rrjedhë afati nga data e daljes në pension, andaj ka kërkuar nga ana e gjykatës që të provohet kërkesë padia si e bazuar.

I ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Përfaqësuesi i të paditurës në fjalën e tij ka deklaruar se nga provat e administruara nuk është vërtetuar baza juridike e kërkesë padisë pasi që me anë të kontratës së punës nuk është paraparë se paditësi me rastin e daljes në pension përfiton në emër të tri pagave jubilare dhe tri paga për përcjellëse në pension, sa i përket kontratës kolektive ka theksuar se e njëjta është nënshkruar në mes SBASHK dhe MSH për të cilën e paditura nuk ka detyrim pasi që nuk e ka nënshkruar të njëjtën.

Njëherit ka theksuar se kërkesë padia sa i përket pagave jubilare është e parashkruar konform nenit 87 të Ligjit të Punës andaj ka kërkuar nga ana e gjykatës që kërkesë padinë e paditëses ta refuzon në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata në këtë çështje bëri administrimin e provave duke bërë leximin e tyre: Padinë e paditësit C.nr.840/17 e dt.22.09.2017, Vërtetimi i lëshuar nga SHMT "Pjetër Bogdani" – Ferizaj me nr.396 i dt. 01.06.2016, Vërtetimin e lëshuar nga SHFMU "Pjetër Bogdani"- Ferizaj me numër protokolli 203 i dt.14.04.2016 në emër të paditësit, ka bërë shiqimin e Librezës së Punës i dt. 12.12.1977 në emër të paditësit fotokopje, Kërkesën e paditësit drejtuar të paditurës në procedurë administrative, Autorizimin e paditësit dhënë avokates, Përgjigjen në padi e të paditurës i dt.15.05.2018, me provat tjera përcjellëse, Kontratën e Punës lidhur mes paditësit dhe të paditurës nr.protokolli 78/16 i dt.01.03.2015, Autorizimin e të paditurës dhënë [REDACTED]

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesë padia e paditësit është e bazuar.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk është kontestuese në mes palëve se paditësi për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension, e paditura nuk e ka kontestuar faktin se paditësi ka përvojën e punës, por e ka kontestuar bazën juridike të kërkesë padisë.

Gjykata me rastin e përcaktimit të lartësisë të tri pagave jubilare, në shumën prej 1,566.33€ si dhe të tri pagave për përcjellje në pension në shumën prej 1,566.33€, ka marr për bazë listën e pagave dhe atë për pagën tre muajve nëntor, dhjetor 2015 dhe janar 2016 për paditësin si dhe njoftimin e lëshuar nga vetë e paditura ku në të është shënuar se paditësja për muajin nëntor, dhjetor dhe janar ka realizuar pagën prej 522.11€, nga këto shifet qartë se paditësi sa ka qenë në marëdhënje pune ka marrë pagën neto prej 522.11€.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesë padisë është bazuar në faktin se me kontratën kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës – Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga të dy palët dhe në nenin 53 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët ndërsa zbatohet prej 01 Janar 2015, kurse me nenin 51 të kësaj kontrate zbatohet në rastet ku ka implikime financiare.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkretë paditësi e ka shfrytëzuar një të drejtë pasi që e njëjta përfiton nga kjo kontratë përfakti se me rastin e daljes së saj në pension kontrata kolektive ka qenë në fuqi.

Në nenin 36 par.9 pika 9.1, 9.2 dhe 9.23 të Kontratës kolektive përfaktore të punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm është përcaktuar që punëtori ka të drejtë në shpërbirim jubilar për 10 vjet të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të një page bazë, përf 20 vjet të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë prej dy page bazë, përf 30 vjet të

përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë prej tri pagave bazë, punëdhënësi i fundit është ai që i paguan shpërblimet jubilare, shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji pas plotësimit të kushteve nga kjo pikë, çka do të thotë se e paditura është dashur që me rastin e daljes në pension paditëses brenda një muaji sipas nenit 36 par.9 pika 9.5 t'ia paguaj tri paga jubilare pasi që e ka plotësuar këtë kusht pasi e ka pasur përvojën e punës mbi 40 vite dhe ka qenë obligim i të paditurës që të bëjë pagesën pa pasur nevojë as për të paraqitur ndonjë kërkësë çoftë gojore apo me shkrim të paditurës.

Kurse në nenin 36 par.10 të Kontratës kolektive për të punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, është përcaktuar se punëtori ka të drejtë që me rastin e pensionimit në pagesën përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit, e në rastin konkretë gjykata ka marr parasysh që tri pagat e fundit të punëmarrësit kanë qenë nga 522.11€ dhe nuk ka pasur ndonjë ndryshim në tre mujorin e fundit para daljes në pension dhe me rastin e vendosjes është bazuar në këtë fakt se meqenëse nuk ka pasur ndryshime në paga që të merret një mesatare e ka marr për bazë tri pagat e fundit që ka marr e në rastin konkretë rezulton se paditësi ka pasur pagën mujore tek e paditura shumën prej 522.11€.

Kurse sa i përket asaj që pagat jubilare janë të parashkruara pasi që me nenin 36 par.9 pika 9.5 kjo bëhet brenda një muaji për çdo 10 vjet kur paditësi i ka bërë, dhe në atë kohë është dashur ta realizon këtë të drejtë, gjykata konsideron se një pretendim i tillë është i pa bazuar se në rastin konkretë nuk kemi parashkrim pasi që sipas nenit 36 par.9 thuhet qartë se për të përfituar paga jubilare punëtori i SBASHK\_u në rastin konkretë paditësi duhet që fillimisht të dalin në pension që të përfitojnë shpërblimin jubilar e jo në kohë sa janë në marrëdhënie pune, respektivisht kur e kanë bërë 10 vjet përvojë pune, 20, apo 30 siç parashihet me këtë nenin 36 par.9 pika 9.1, 9.2 dhe 9.3.

Se pretendimi i të paditurës është i pa bazuar se në rastin konkretë nuk kemi të bëjmë me institutin e parashkrimit pasi që kjo është e rregulluar me dispozitat ligjore të Ligjit të Punës nr.Ligjit 03/L-212, dhe çështja e parashkrimit është e rregulluar në nenin 87 dhe ky afat nuk mundet me u ndryshuar me marrëveshje mes palëve, se në rastin konkretë nuk kemi të bëjmë me zbatimin e institutit të parashkrimit është edhe përfaktin se në nenin

36 oar.9 pika 9.4 thuhet decidivisht se punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblimin jubilar, e që në rastin konkretë rezulton se paditësi ka dalur në pension tek e paditura dhe kjo e ka për obligim që t'ia paguaj paditësit tri pagat jubilare, dhe ky obligim rrjedhë nga koha e daljes në pension e që në rastin konkretë paditësi ka dalur në pension me dt.31.01.2016, kurse padinë e ka paraqitur në gjykatë me dt. 22.09.2017 që nënkupton brenda afatit ligjor 3 vjeçar.

Gjykata në lartësinë e aprovuar të kompensimit të tri pagave jubilare dhe tri pagave për përciellje në pension, paditësit i ka njohur të drejtën në kamatës nga dita e paraqitjes padisë deri në pagesën definitive në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452.1 të LPK-së, andaj obligohet e paditura që paditësit tia apguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshëm prej 279€ dhe atë për taksën gjyqësore për padi 40€, përpilim të padisë shumën prej 104€ si dhe për përfaqësimin në një seanc nga avokati shumën prej 135€

Nga sa u tha më lartë është vendosur si në dispozitav të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**C.nr.840/17, me datën 15.08.2018**

Gjyqtari,  
Alban Beqiri



**KESHILLA JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar që kësaj resa në afatin prej 7 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNO-SNAZNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ II UROŠEVAC

03.10.2018

